

Informacion per subjektin “Partia Lidhja popullore Shqiptare”

Për kryerjen e auditimitin e fondeve te përfituara dhe shpenzuara nga Partia Lidhja popullore Shqiptare për vitin kalendarik 2020

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Subjektit “Partia Lidhja popullore Shqiptare”Tiranë

Me cilesine e Audituesit Ligjor (Ekspertit Kontabël te Regjistruar), të caktuar Vendimit Nr. 425 date 12/07/2021 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve “ Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve kontabel te licensuar, te cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga partite politike per vitin kalendarik 2020”për realizimin e auditimit kemi kryer procedurën e mëposhtme:

Mbas nënshkrimit të Kontratës Kontrates se sherbimit me nr. 6274 date 23/08/2021 e lidhur me Komisionin Qendror te Zgjedhjeve per auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga “Partia Lidhja popullore Shqiptare”, kerkuam informacion ne lidhje me Kryetarin dhe adresen e kesaj Partie.

Nga procedurat e kryera nuk siguruam asnje informacion ne lidhje me kete parti, per adresen e saj.

Urdheri per rregjistrim eshte i vetmi dokument qe kemi gjetur, ne te cilin nuk eshte e shkruar adresa dhe as kryetari.

Si konkluzion për shkak se procedurat e mësipërme nuk përbëjnë auditim dhe as rishikim të bërë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të auditimit ne nuk mund të shprehim asnjë opinion për fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit 2020 nga “**Partia Lidhja popullore Shqiptare**”.



Tiranë me 23/09/2021

BLV, Gjeigj Fishta, Pall G& P, hyrja II, Kati II, mbi Credins Bank, Tiranë,
Nr. Kontakti Cel.0692087743 , e-mail pulaj_anita@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSSISË
DREJTORIA E KODIFIKIMIT
Nr. 39

U R D H Ë R

Nr. 39 Datë 31.8.91

PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT TË PARTISË "LIDHJA POPULLORE SHQIPTARE"

Në Ministrinë e Drejtësisë është paraqitur kërkesa e komisionit nismëtar për krijimin e Partisë "Lidhja Popullore Shqiptare", të cilës i bashkëngjiten programi, statuti e dokumente të tjera.

Pasi u njoha me përmbajtjen e këtyre dokumenteve, konstatova se ato pajtohen me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese dhe plotësojnë kërkesat e ligjit "Për partitë politike".

Prandaj, në mbështetje të nenit 11 të ligjit Nr.7502 datë 25.7.1991 "Për partitë politike";

U r d h ë r e j :

1. Miratimin e krijimit të Partisë "Lidhja Popullore Shqiptare", regjistrimin e saj në regjistrin përkatës dhe depozitim të dokumentave në arkivin e kësaj ministrie.
2. Kopja e kësaj urdhëri t'i dërgohet komisionit nismëtar për krijimin e kësaj partie.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

M I N I S T R I
Dr. Shefqet Muçi